



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 02 prill 2020, në mbledhjen e XXX (tridhjetë), e jashtëzakonshme, të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

Mbledhja filloi në orën 10;15 dhe u mbajt në Teatrin e Qytetit “Avdush Hasani” (për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19).

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës, (35 - Lista e nënshkrimeve).

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin edhe Drejtorët e Drejtorive të Administratës komunale.

Rendi i Ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe duke iu dëshiruar mirëseardhje, dhe shtoi, këtë mbledhje po e mbajmë në kushte dhe rrethana tjera për shkak të Coronavirusit COVID-19 që tani më veç jeni në dijeni që është përhapur në gjithë botën dhe që nga Organizata Botërore e Shëndetësisë është shpall pandemi.

Thirrja dhe materiali për këtë mbledhje ju është dërguar me kohë të gjithëve, konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së po ashtu ju janë dërguar. Jeni në dijeni se kjo mbledhje e jashtëzakonshme është thirrur me iniciativën e Nënkryetarit të Komunës me qëllim që të jepen informata dhe të ndërmerren masa lidhur me këtë gjendje që na ka kapluar për fat të keq edhe neve si shtet, andaj nëse ka të lajmëruar për të marrë fjalën urdhëroni nëse jo e hedhin në votim rendin e propozuar të ditës duke përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së.

z.Adnan Zymeri, theksoi, meqë jemi në një situatë jo të zakonshme dhe meqë këto ditë kemi parë përkushtimin e jashtëzakonshëm të punëtorëve të shërbimeve publike por edhe punëtorëve tjerë të sektorit privat të cilët neve si qytetarë na kanë nderuar me shërbimet e tyre, atëherë ne meqë jemi institucioni më i lartë i përfaqësimit qytetarë në nivel lokal, kërkoj që të ngritemi në këmbë të gjithë dhe bashkërisht të përshëndesim angazhimin e tyre me një duartrokitje për rreth 1 minutë.

Me duartrokitje nga ana e të gjithë të pranishmëve, përshëndetet angazhimi i gjithë punëtorëve për dhënien e shërbimeve për qytetarët e Komunës së Podujevës.

Kryesuesi i Kuvendit, ftoj për votim të rendit të propozuar të ditës përfshirë edhe rekomandimet nga mbledhja e KPF-së.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri nga anëtarët e Kuvendit, u miratua rendi i propozuar i ditës, përkatësisht u mbështet që të vazhdohet sipas thirrjes së kësaj mbledhje me rendin e ditës si në vijim, si dhe duke përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

➤ **Masat për parandalimin dhe luftimin e Corona Virusit COVID-19**

- **Informatë rreth aktiviteteve, masave dhe menaxhimit të situatës nga Corona Virus COVID-2019.**
- **Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë 125,000.00€, ndihmë qytetarëve në nevojë me pako ushqimore dhe hixhienike.**
- **Propozimi i vendimit për lirim nga taksa komunale e të gjitha Subjekteve afariste që ushtrojnë veprimtari në territorin e Komunës së Podujevës për vitin 2020.**
- **Propozimi i vendimit për lirim nga pagesa e qirasë për të gjithë shfrytëzuesit e pronës Komunale për vitin 2020.**

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, pra kemi këtë pikë të rendit të ditës dhe nënpikat përkatëse të cilat ndërlidhen ne masat për parandalimin dhe luftimin e Corona virusit COVID-19, andaj për fillim fjalën e ka Nënkryetari i Komunës z.Nexhmi Rudari që të paraqes informatë në fjalë dhe masat e propozuar rreth sipas nënpikave në fjalë sipas rendit materialit të dërguar.

z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, duke përshëndetur të pranishmit dhe gjithë qytetarët paraqiti informatën në fjalë, ndër të tjera theksoi, përhapja e Corona virusit COVID-19 nuk e anashkaloj Kosovën e as Podujevën. Institucionet lokale dhe qendrore u mobilizuan, sipas mundësive dhe kompetencave që kanë, që ta parandalojnë dhe luftojnë përhapjen e tij sa më shumë që është e mundur. Në këtë kuadër, komuna kishte filluar me masa konkrete qysh nga 25 shkurti i këtij viti me funksionalizimin e një pike kontrolli shëndetësor në pikën kufitare në Merdar, me katër ekipe mjekësore, që vazhdojnë edhe në ditën e sotme të kontrollojnë të gjithë udhëtarët që hyjnë në Kosovë përmes kësaj pike. Deri më tani në këtë pikë janë kontrolluar mbi 5700 udhëtarë që kanë hyrë në Kosovë përmes këtij kufiri e që është numër dukshëm më i madh se në çdo pikë tjetër kufitare në Kosovë. Paraqitja e rastit të parë me COVID-19 në Komunën tonë kishte ndodhur më 15 mars 2020, në fshatin Dumnice e Epërme, dhe me të marrë këtë lajm, sipas udhëzimeve të Qeverisë, me vendim të veçantë kam themeluar Komisionin për Veprime dhe Masa Kundër Virusit Corona. Menjëherë kemi marrë masa dhe kemi dërguar një ekip mjekësor në krye me epidemiologun Dr.Bedrie Rama, një njësi të Policisë si dhe kompaninë për dezinfektim e cila kishte bërë dezinfektimin e hapësirave të brendshme dhe të jashtme të familjes ku ishte paraqitur rasti.

Pas paraqitjes së rastit të parë, Instituti Kombëtarë i shëndetit Publik - IKSHIP kishte vlerësuar se katër fshatrat (Dumnice e Poshtme, Dumnice e Epërme, Llaushë dhe Përpellac) duhet të futeshin në karantinë, gjë që për neve ka qenë një masë jo proporcionale dhe ne vazhdimisht kemi kërkuar që kjo masë të ndërrohet me një masë më të lehtë siç është “izolim” i familjes apo edhe i lagjes.

Me 16 mars 2020 është formuar ekipi mjekësor për triazhim (katër ekipe) si dhe është caktuar objekti për karantinë brenda hapësirave të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare - QKMF në Podujevë.

Më 17 mars 2020 ishte konfirmuar që edhe një anëtar i familjes Haliti (babai i të infektuarit të parë) kishte rezultuar pozitiv, e që fatkeqësisht, ai pas 5 ditëve nuk i kishte mbijetuar këtij virusi dhe kishte ndërruar jetë duke u bërë viktima e parë në Kosovë me COVID-19, e dhashtë Zoti të jetë e fundit.

Më 18 mars 2020 ishte konfirmuar se edhe motra e të infektuarit të parë, e cila jeton në fshatin Bradash, ishte prekur nga ky virus dhe ishte dërguar në Klinikën Infektive të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës - QKUK për trajtim, dhe menjëherë kemi dërguar ekipin mjekësor për kontroll të anëtarëve të tjerë të familjes, njësinë e Policisë dhe kompaninë për dezinfektim e cila kishte bërë dezinfektimin e hapësirave të brendshme dhe të jashtme të familjes dhe familja ishte futur ne izolim.

Më 27 mars dy të prekurit e parë me virusin corona janë liruar si të shëruar nga Klinika Infektive, për trajtim të mëtutjeshëm në shtëpi dhe gjendja e tyre shëndetësore është e mirë dhe pa asnjë problem shëndetësorë. Asnjë nga anëtarët e këtyre dy familjeve nuk ka treguar simptoma se janë të prekur nga ky virus, kjo falë edhe diciplinës së tyre të treguar për t'ju përmbajtur udhëzimeve të mjekëve.

Më 28 mars 2020 është identifikuar edhe një rast me COVID-19, një grua në Podujevë. Menjëherë kemi marrë masa dhe kemi bërë izolimin e familjeve, dezinfektimin e shtëpive dhe hapësirave të tjera. Gjendja e pacientes është e mirë dhe anëtarët të tjerë të familjeve nuk kanë simptoma që janë prekur nga ky virus.

Më 28 mars 2020 janë marrë mostrat e 10 mjekëve dhe infermierëve të QKMF të dyshuar se mund të kishin pasur kontakt me pacientët që kanë qenë të infektuar, por fatmirësisht të gjithëve u kanë dalë analizat negative dhe kjo vërtetë ishte një lehtësim i madh si për QKMF-në ashtu edhe për institucionet dhe qytetarët.

Komuna përmes Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale - DSHMS ka realizuar 4 furnizime me mjete mbrojtëse për personelin shëndetësor, por jo vetëm, në shumë prej 133.000.00€ (*maska speciale me respirator, uniforma mbrojtëse për personelin shëndetësor, syze mbrojtëse, dorëza dhe dezinfektues për duar si dhe pajisje tjera shëndetësore dhe mjekësore*), si dhe ka ndarë një buxhet prej 94.000.00€ për dezinfektimin e hapësirave përtej kontratës që kishim më herët. Ministria e Shëndetësisë ka furnizuar QKMF-në disa herë me mjete mbrojtëse por sasia e furnizimeve ka qenë tejet e ulët dhe nuk i ka plotësuar as për së afërmi nevojat dhe kërkesat e personelit mjekësor, Policëve dhe Zjarrfikësve.

Pas shpalljes së gjendjes emergjente shëndetësore nga ana e Qeverisë, Drejtoria e Inspektionit ka ndërruar rutinën e punës duke formuar katër ekipe punuese për të punuar në dy ndërrime në mënyrë që të mbikëqyrë në tërësi zbatimin e vendimeve të Qeverisë në territorin e Komunës së Podujevë. Personeli shëndetësor i QKMF-së ka bërë një punë të shkëlqyer duke qenë në ballë të luftës për parandalimin e përhapjes së virusit Corona.

Gjatë gjithë kohës Kompania “DDD” ka dezinfektuar hapësirat publike (*sheshet e rrugët, hyrjet e banesave kolektive në Podujevë, Lagjen e Dëshmorëve, institucionet publike si QKMF, emergjencën, dhomën e triazhimit, Policinë, autoambulancat, kamionët për transportin e mbeturinave etj.*), e rëndësi të veçantë iu ka kushtuar dezinfektimit të përditshëm të QKMF-së, emergjencës, dhomës së triazhimit, pikës mjekësore në Merdar, Ambulantave të Mjekësisë familjare - AMF-ve në Dumnice dhe Bradash.

Kompanitë për transportin e mbeturinave dhe pastrimit të rrugëve kanë qenë në nivel të detyrës edhe pse është dashtë që për çdo ditë të futen brenda perimetrit të zonës në karantinë.

Policia e Kosovës, e cila edhe përkundër numrit jo të mjaftueshëm të stafit, ka arritur që të gjithë qytetarëve t'ju gjenden pranë duke siguruar jetën dhe pronën e të gjithëve si dhe duke u kujdesur që të zbatohen vendimet e Qeverisë dhe Komisionit Komunal për parandalimin e përhapjes së virusit Corona.

Që nga fillimi i paraqitjes së rastit të parë dhe futjes në karantinë të fshatrave të lartcekura, ne kemi kontaktuar shumë donatorë të mundshëm dhe kemi bashkërenditur aktivitetet me ta që t'ju dalim në ndihmë qytetarëve në nevojë. Fillimisht jemi dakorduar që çdo ndihmë të shpërndahet vetëm nga një burim, Kryqi i Kuq i Kosovës - Dega në Podujevë, në mënyrë që të pamundësojmë përfitimin e individëve të caktuar të dy e më shumë ndihmave. Listat kryesisht janë hartuar sipas listave prioritare nga Qendra për Punë Sociale, DSHMS si dhe kërkesave nga kryetarët e komiteteve të fshatrave dhe vetë qytetarëve.

Pakot e para ushqimore dhe higjienike i kemi shpërndarë për qytetarët në karantinë, në sasinë prej 100 pakove të dhuruara nga Kompania FESTIMI.

Pastaj 250 pako ushqimore dhe higjienike të dhuruara nga Viva Fresh dhe Buqaj.

100 pako nga Shoqata Humantiare “Nëna Terezë”.

100 pako nga Shoqata “Jetimat e Ballkanit” që përfshinin edhe nga një thes miell prej 25 kg.

600 pako (miell, qumësht dhe lëngje) nga ELKOS Group.

3500 kg miell nga donatori Fatmir Ejupi (Alb Petroll).

4500 kg miell nga Shoqata Firdeus, Berqeti dhe Këshilli i Bashkësisë Islame në Podujevë.

200 pako ushqimore dhe higjienike nga Komuna e të cilat do të shpërndahen nga Kryqi i Kuq.

Nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural janë ndarë nga 2 m³ dru për ngrohje për 69 familje në nevojë.

100 palë rroba mbrojtëse janë dhuruar nga Dr. Ukë Berisha.

Një respirator është dhuruar nga Ragip Mustafa (Beni Dona), duke e bërë QKMF në Podujevë të vetmen në Kosovë të pajisur me një aparat të tillë, dhe,

1000 palë dorëza nitrile për QKMF-në të dhuruar nga Driton Hyseni.

Në këtë periudhë janë paraqitur edhe shumë zjarre të shkaktuara nga individ të papërgjegjshëm si në pyjet publike ashtu edhe në ato private (si në Majac, Popovë, Potok, Sylevicë, Pakashticë, Reçicë, Metehi, Dumnicë, Lladoc dhe Shajkoc) ku nga zjarri janë përfshirë rreth 80 ha pyje. Njësia e zjarrfikësve në Podujevë, së bashku me rojet e pyllit dhe në disa raste edhe qytetarët kanë punuar shumë që zjarret të mbahen nën kontroll dhe të shuhen tërësisht.

Komuna e Podujevës deri më tani, pa llogaritur shumën që do të ndani sot, ka ndarë 237.000.00€ për t’u përballur me sukses në luftë me përhapjen e virusit Corona.

Furnizimi me artikuj ushqimor i maketeve, furrave të bukës dhe shitoreve të tjera ushqimore është për t’u admiruar. Një punë të palodhshme kanë bërë edhe të gjithë mullinjtë në territorin e komunës duke mos lënë për asnjë moment qytetarët të pa furnizuar me artikullin bazë ushqimor që është mielli.

Komuna e Podujevës mbetet e përkushtuar që të shfrytëzoj të gjitha kapacitetet, në bashkëveprim edhe me Qeverinë e Kosovës, që të parandalojë dhe luftojë përhapjen e virusit Corona duke mbrojtur shëndetin publik të gjithë qytetarëve llapjan. Një falënderim i veçantë shkon për donatorët e shumtë, vullnetarët dhe punëtorët e Kryqit të Kuq të Kosovës në Podujevë si dhe për të gjithë qytetarët që janë treguar të kujdesshëm dhe të disiplinuar në zbatimin e urdhrave dhe rregullave të IKSH, Policisë dhe Shtabit emergjent në Podujevë.

Të nderuar këshilltarë/e dhe ju të pranishëm tjerë, në këto ditë të vështira më kanë telefonuar me dhjetëra këshilltarë e me qindra qytetarë për të ofruar vetën e tyre në shërbim të luftës me këtë të keqe, për çka i falënderoj pa masë të gjithë. Edhe njëherë erdhi në shprehje shpirti fisnik, humanitar e solidar i popullit tonë.

Ne mbetemi të përkushtuar dhe të angazhuar që t’i zvogëlojmë pasojat e kësaj pandemie, njëkohësisht ta luftojmë dhe parandalojmë përhapjen e saj sa më shumë që është e mundur. Kjo arrihet vetëm po që se ne jemi të bashkuar si asnjëherë më parë për ta mposhtur edhe këtë sfidë për institucionet dhe popullin tonë. Zoti na ndihmoftë.

Kryesuesi i Kuvendit, e falënderon Nënkryetarin e Komunës për informatën dhe kontributin e dhënë rreth çështjeve në fjalë, dhe shtoi, nëse ndokush nuk diçka rreth kësaj informate, vazhdojmë me nënpikën sipas radhës përkatësisht propozim vendimin për ndarjen e mjeteve buxhetore prej 125,000.00€ ndihmë qytetarëve në nevojë me pako ushqimore dhe higjienike.

z.Vendenis Lahu, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, duke uruar shëndet të të gjithëve dhe duke shpreh ngushëllime familjes së të ndjerit nga Komuna jonë të prekur me Corona virus dhe

njëkohësisht duke uruar shërim të shpejt të gjithë të prekurve tjerë anembanë vendit. Gjithashtu duke përgëzuar dhe falënderuar të gjithë ata që gjinden në front të luftës ndaj pandemisë për të cilët potencoj se janë duke bërë një punë të shkëlqyeshme në mënyrë që aspektet kryesore të jetës tonë të mbahen në funksion, pra falënderim i veçantë për stafin mjekësor, Policinë, furrtarët, shitësit në dyqane, barnatoret, zjarrfikësit, pastruesit dhe gjithë të tjerët të cilët në një formë apo mënyrë po japin kontributin e tyre.

Theksoi, të nderuar, më duhet të potencoj se për këtë mbledhje të jashtëzakonshme ne nuk kemi marrë ashtu siç e donë rendi, informatë të shkruar lidhur me pikën e rendit të ditës, pra konstatoi se nuk është respektuar Rregullorja e Punës së Kuvendit, më saktësisht neni 26 pika 2, shkronja e) që parasheh se në thirrjen e mbledhjes, përveç rendit të ditës duhet të dërgohen edhe materialet e propozuara për shqyrtim, kjo nuk ka ndodhur dhe e gjithë informata na u servua sot në këtë formë që lë shumë për të analizuar dhe për tu dëshiruar. Deri më tani në Komunën tonë kemi vetëm 4 raste apo persona të prekur me Corona virus, kjo falë ngritjes me kohë të alarmit nga IKSHP për rrezikun, masave të shpejta dhe menaxhimit të mirë nga Ministria e Shëndetësisë si dhe pakove ekonomike nga Qeveria e Kosovës për ndihmë qytetarëve siç ishin pakoja e ndihmave sociale dhe pensioneve, pagat e punëtorëve në sektorin privat, pakoja për mbështetje për komunat e Kosovës, por edhe shkak i përgjigjes së mirë të qytetarëve.

Gjithsesi edhe niveli lokal ka përgjegjësit e tij dhe format e veta për tu gjendur pran qytetarëve në nevojë, është në mundësi të Komunës dhe tejet e rëndësishme që të bëhet dezinfektimi i hapësirave të banimit tek rastet e prekura dhe personat e kontaktit siç ishte rasti në fshatin Dumnice ku Komuna kishte dështuar të bënte dezinfektimin e shtëpive në lagjen ku ishte paraqitur i prekuri i parë edhe pse publikisht kishte thënë se dezinfektimi ishte kryer për tu përgënjeshtuar më pas nga vetë banorët e atij fshati. Është e mirë pajisja e stafit të urgjencës me uniforma speciale por do të ishte mirë që me ato uniforma speciale të pajiseshin edhe punëtorët tjerë të QKMF-së. Gjithashtu do të ishte e udhës edhe hapja e një linje telefonike përmes së cilës qytetarët do të mund të njoftoheshin rreth Corona virusit, po ashtu furnizimi me dezinfektant i të gjitha hollëve të institucioneve shëndetësore dhe mundësimi i shërbimeve të administratës online.

Sa i përket propozim vendimit për ndarjen e shumës prej 125,000.00€ për ndihmë qytetarëve në nevojë me pako ushqimore dhe hixhienike, edhe këtu mungon një përshkrim i nevojshëm, mungon një plan në bazë të të cilit do të përcaktoheshin edhe pakot e ndihmës por edhe qytetarët të cilët do të përfitonin në këto pako, por që nuk ka kurrfarë plani se si të veprohet përveç ndarjes së mjeteve.

Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së propozon shumën prej 150,000.00€ duke ju rikujtuar se ju si Ekzekutiv i Komunës nuk keni shfrytëzuar mundësinë e dhënë nga niveli qendrorë që ka lejuar bartjen e mjeteve nga Komuna deri në 5% të vlerës së investimeve kapitale, ashtu siç kanë vepruar disa Komuna tjera, por të gjitha mjetet i keni paraparë nga burimi i të hyrave vetanake përmes Drejtorive, gjë kjo e cila nuk është e mirë sepse kur pastaj të kaloj pandemia, dhe besoj se do të kaloj, ne do të jemi prap këtu që t'iu dalim në ndihmë edhe fermerëve por edhe njerëzve të kulturës si dhe qytetarëve tjerë pa dallim.

Gjithashtu krahas kësaj shume prej 150,000.00€, ne propozojmë që Kuvendi të përcaktoj kriteret për këto pako dhe të ngritët një komision me nga një anëtarë prej secilit subjekt politik që është i përfaqësuar si Grup në Kuvendin e Komunës me qëllim të mbikëqyrjes së mbarëvajtjes së procesit të shpërndarjes së këtyre pakove.

Sa i përket propozim vendimit për heqjen e taksës komunale për të gjitha subjektet afariste që zhvillojnë aktivitetin e tyre në territorin e Komunës së Podujevës, për vitin 2020, ne si Grup nga radhët e LVV-së jemi për lirim nga taksa komunale sepse kjo është edhe e paraparë në programin tonë. Kjo është një taksë e panevojshme që rëndon subjektet afariste dhe është në fuqi pothuajse

vetëm në Komunën tonë, prandaj ne jemi që ata të lirohen por jo vetëm për vitin 2020 por të lirohen në mënyrë permanente.

Sa i përket propozim vendimit për lirim nga pagesa e qirasë për të gjithë shfrytëzuesit e pronës komunale për vitin 2020, unë në fakt në emër të Grupit të këshilltarëve paraqita opinionin për të gjitha nënpikat sepse edhe në mbledhjen e KPF-së kështu edhe është diskutuar, por që edhe këshilltarët tjerë do të diskutojnë veç e veç për këto pika, megjithatë rreth kësaj pike mendoj se të gjitha masat i ka marrë Qeveria e Kosovës për 2 muajt e ardhshëm ngase pandemi nuk pritet të zgjatë më shumë, dhe për çdo eventualitet ne jemi këtu prandaj në këtë kontekst e shoh paska të çuditshme faljen e qirave për tërë vitin kur kjo mund të bëhet fillimisht për 3 muaj dhe pastaj nëse ka nevojë kjo periudhë mund të zgjatet, por çka është më e rëndësishmja aspekti ligjor nëse Komuna ka të drejtë të bëjë faljen e qirave, do të thotë të shkelen kontrata e nënshkruara.

z.Qëndrim Softolli, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e LDK-së, theksoi, jemi mbledhur sot në këtë seancë jo të zakonshme për ta dhënë kontributin tonë në ndihmë qytetarëve të Komunës së Podujevës në tejkalimin e gjendjes së krijuar nga Pandemia e shkaktuar nga virusi COVID-19.

Ky virus i tmerrshëm, i cili po vendosë në sfidë edhe shtete të fuqishme të botës të cilat kanë sisteme shëndetësore shumë më të avancuara, sigurisht që është vështirë i menaxhueshëm edhe për vendin tonë kur dihet se kemi një sistem shëndetësorë shumë më të dobët se vendet tjera.

Në rastet si kjo, e me një gjendje të tillë nevojitet mobilizim i përgjithshëm në mënyrë që secili të jap nga vetja kontribut për tejkalimin e situatës së krijuar si pasojë e Pandemisë.

Komuna e Podujevës me kohë ka ndërmarrë masa në përputhje me kapacitetet dhe kompetencat që ka, andaj dua ta përgëzoj Shtabin Emergjent Lokal, të udhëhequr nga Nënkryetari i Komunës z.Nexhmi Rudari dhe të gjithë anëtarët tjerë përfaqësues të institucioneve të ndryshme të cilët çdo ditë po përballen me këtë gjendje.

Me ndjenjën më të thellë të mirënjohjes falënderoj punëtorët shëndetësorë të cilët më punën, sakrificën dhe profesionalizmin e treguar janë shndërruar në heronjtë tanë. Po ashtu falënderim të veçantë për sektorin e sigurisë të emergjencave dhe të gjithë të angazhuarit e tjerë që falë angazhimit të tyre po e bëjnë më të lehtë përballimin e kësaj sfide të madhe për secilin prej nesh.

Përgëzoj Shtabin Emergjent të cilët po qëndrojnë në krye të detyrës duke u ofruar ndihmën e kërkuar nga qytetarët të cilët po kërkojnë mbështetje që është plotësisht normale në raste si kjo. Kjo situatë do të ishte shumë më vështirë e përballueshme pa ndihmën e donatorëve dhe vullnetmirëve të cilët në forma të ndryshme çdo ditë po ndihmojnë qytetarët tanë, familjet në nevojë. Të dashur qytetarë, është zgjidhja e duhur që Shtabi Lokal ka vendosur që secila ndihmë që vjen, e njëjta të shpërndahet përmes Kryqit të Kuq, andaj dua ta bëj një falënderim të merituar për ekipin dhe vullnetarët e Kryqit të Kuq në Podujevë të cilët po kujdesen që ndihmat t'i dërgojnë në secilën familje në nevojë.

Të gjitha këto veprime kanë ndikuar që të përballohet sa më mirë kjo gjendje, mirëpo sigurisht kjo nuk është e mjaftueshme sepse jemi ende në fazë kritike dhe askush nuk e di së sa do të zgjasë kjo. Me qëllim që të krijojmë kushte sa më të mira dhe të sigurojmë furnizime të nevojshme e te domosdoshme për të gjithë të mobilizuarit që u cekën më lartë, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së jemi në mbështetje të plotë të Komunës së Podujevës, përkatësisht, Shtabit Emergjent Lokal në secilën kohë dhe secilën iniciativë që ndihmon në përballimin sa më të mirë të situatës dhe u del në ndihmë e mbrojtje qytetarëve llapjan.

Për fund, duke ju uruar shëndete të mirë të gjithëve, shfrytëzoj rastin t'u bëj thirrje të gjithë qytetarëve të respektojnë më përpikmëri rekomandimet e instancave qendrore dhe lokale dhe secili ta japë kontributin e tij në parandalimin e përhapjes së virusit, si dhe duhet të jemi te durueshëm, të

qëndrojmë në shtëpi, t'u japim mbështetje instancave që po e kryejnë detyrën e tyre dhe të mos bëjmë panik.

z.Pajtim Hodolli, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e PDK-së, theksoi, fillimisht dëshiroj të falënderoj të gjithë mjekët, policët, furrtarët, FSK-së, KEK-un, organizatat humanitare dhe të gjithë ata të cilët janë duke punuar në shërbim të qytetarëve në këto ditë të vështira nga Corona virusi i njohur si COVID-19.

Sot në këtë mbledhje të jashtëzakonshme jemi mbledhur për t'i ndihmuar qytetarët e Komunës së Podujevës nga ky virus i cili tashmë është prezent në tërë vendin, andaj lidhur me këtë, unë propozoj disa gjëra që mendoj se janë në shërbim të qytetarëve të Komunës sonë.

-Të formohen nën shtabet emergjente nëpër fshatra të cilat do ta kenë për obligim monitorimin e gjendjes lidhur me masat preventive gjatë kësaj gjendje.

-Të formohet komisioni për shpërndarjen e ndihmave, në mënyre që ato të mos keqpërdoren për nevoja elektorale, dhe në këtë komision të përfshihen të gjitha subjektet politike, ndonjë OJQ dhe ndonjë përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame në Podujevë.

-Ndihmat t'u shpërndahen atyre familjeve që kanë të ardhura më pak se 170.00€ në muaj, pavarësisht a janë në asistencë sociale apo jo.

-Të bëhet dezinfektimi sa më i shpeshtë i hapësirave publike, dhe

-Fondi prej 125,000.00€ euro të rritet në 200,000.00€, dhe këtë e bazoj në rastet që janë shfaqur në Komunën tonë dhe duke krahasuar me shumicën e komunave tjera të cilat janë shumë më të vogla se Komuna e Podujevës dhe të cilat kanë ndarë shifra më të mëdha.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, duke marrë parasysh gjendjen emergjente Komuna jonë në sektorin e shëndetësisë lidhur me menaxhimin Covid-19 i neglizhon disa gjëra si, tenda/shatori para maternitetit qëndron si suvenir i pa pajisur me mjetet e nevojshme për menaxhimin e Covid-19, mungesa e uniformave dhe materialit mbrojtës të personalit shëndetësorë në ambulanta dhe në terren, dezinfektimi pa orar dhe me vonesa në kohë të gjatë pas thirrjeve edhe kur ka raste të dyshuar me Covid-19, oraret diskriminuese në mes personelit shëndetësorë në kuptimin e organizimit, puna në vijën e parë me pacientë të dyshuar me Covid-19 pa rotacion mes personelit, diskriminimi mes personalit shëndetësorë lidhur me marrjen e pushimit ku disa ju lejohet disave jo, mosfunksionimi që 14 ditë i punës dhe laboratorit të analizave ku aty bëhen vetëm hemogrami dhe urina pa analiza biokimike që janë të nevojshme për pacientët, numër i pamjaftueshëm i vozitësve për ambulancave ku në disa raste mjeku obligohet të vozis vetë gjatë ndërrimit, mos mbajtja e distancës mes pacientëve me Covid-19 në korridoret e QKMF-së. Në këtë kohë kërkojmë të përfordhet ekipa e triazhimit kur dihet se ata janë ekip mobile dhe i njëjti është i obliguar të del në terren që të transportoj pacientët e infektuar për në QKUK, atëherë ordinanca mbetet bosh pa praninë e tyre, kërkojmë që në banesat kolektive të vendosen dezinfektues kur dihet që edhe në banesat e Prishtinës tash e tri ditë janë pajisur me dezinfektues.

Pra të nderuar kolegë dhe ju Ekzekutiv i nderuar, jemi një Komunë ku QKMF ka respirator por nuk ka tubues endotrahial dhe po ashtu kemi respirator por shumë shpesh mbetemi pa oksigjen që është jeta e mushkërive të pacientëve, kështu që shpresojmë që këto mjetet të destinohen në vendet e duhura e më së shumti aty ku është shpresa e shpëtimit – shëndetësia.

z.Afrim Shabani, theksoi, vërtetë është një gjendje e jashtëzakonshme dhe për ata edhe është thirr kjo mbledhje e jashtëzakonshme, andaj falënderoj të gjithë punëtorët shëndetësorë të cilët janë duke dhënë kontributin tyre në mënyrën më të dinjitetshme. Sa i përket mobilizimit të QKMF-së dhe në bazë të raportit të tyre ekziston edhe shërbimi i triazhimit i cili kryen detyrat e tyre, përkatësisht bënë triazhimin e pacientëve të cilët kërkojnë shërbim shëndetësorë në QKMF, pastaj kanë edhe qendrën e thirrjeve e cila është 24 orë në dispozicion që monitoron dhe orienton rasatet, mandej bëhet edhe

intervenimi në familjet e izoluar si dhe transportin me autoambulancë të atyre rasteve që janë të nevojshme deri në QKUK-Prishtinë.

Sa i përket aspektit të furnizimit të QKMF-së me mjete mbrojtëse është e kënaqshme nga ana e Komunës së Podujevës për arsye se deri tani janë bërë 4 porosi dhe atë në sasi të mjaftueshme në krahasim me furnizimet e bëra nga Ministria e Shëndetësisë kohën e fundit me një sasi mjaft të vogël, andaj shpresoj dhe dhashtë Zoti ta tejkalojmë këtë situatë e cila nuk është aspak për ta neglizhuar ashtu sikurse nuk është aspak për ta kritikuar ndokënd që dikush pastaj të përfitoj në aspektin politik apo në forma tjera të ndryshme nga kjo situatë, por duhet të angazhohemi të gjithë që ta tejkalojmë sa më lehtë këtë situatë.

z.Avni Islami, theksoi, kryesisht dëshiroj të jap një propozim si dhe të t'ju informoj rreth gjendjes në zonën e cila është në karantinë tash e 18 ditë, ngase vijë nga ajo zonë.

Propozimi është që ne si Kuvend i Komunës të ndërmarrim një vendim që secili lokal afarist të jetë i pajisur me material antibakterial në mënyrë që secili qytetarë para se të hyjë në lokal të bënë dezinfektimin e duarve dhe të njëjtën gjë ta bëjë në dalje, çështje kjo e cila mendoj se është një masë jashtëzakonisht efektive dhe efikase dhe nuk jam në dijeni se a është vendosur kjo në ndonjë Komunë tjetër por do të doja që të jemi Komuna e parë në Kosovë që ndërmarrë këtë hap në mënyrë që të bëhet parandalimi i përhapjes së Corona virusit Covid-19.

Në të njëjtën kohë shpreh shqetësimet e mia nga zona prej nga unë vijë e që mendoj se në një zonë ku për 14 ditë nuk është lajmëruar asnjë rast konsiderohet se nuk ka indikacione për ndonjë person tjetër të infektuar. Është një menaxhim jo i mirë i institucioneve përkatëse dhe është një frustrim i katër fshatrave (Dumnica e Poshtme dhe ajo e Epërme, si dhe Llausha e Poshtme dhe Epërme) se si është e mundur të lëshohet ky gabim dhe që ne që 18 ditë të jemi në karantinë dhe që qytetarëve ju është vështirësuar jeta dhe po ka raste ku po përdoren rrugë alternative që të furnizohen me gjëra e nevojshme.

Për fund, duke uruar që kjo Pandemi të kaloj sa më shpejt dhe sa me më shumë sukses, kam një apel tek të gjithë përfaqësuesit e subjekteve politike që në këtë situatë të jashtëzakonshme, e që neve dita ditës po na bëhet e zakonshme, të gjitha propozimet, vërejtjet dhe sugjerimet, të mos kenë ngjyrimet politike sepse këtu jemi të gjithë përfaqësues të popullit andaj edhe kërkohet nga ne të japim kontributin tonë në formë të ndryshme.

z.Fatmir Rudari, theksoi, fillimisht shfrytëzoj rastin që familjes Haliti nga fshati Dumnica e Epërme e Podujevës t'i shpreh ngushëllime të sinqerta për humbjen e anëtarit të tyre të familjes si pasojë e Covid-19. Të gjithë të prekurve që kanë simptoma apo që janë të prekur nga ky virus ju dëshiroj shërim të plotë dhe sa më të shpejtë.

Shpreh keqardhje për gjendjen në të cilën ndodhemi ku edhe vendi ynë është përfshirë nga një virus i njohur me prejardhje, me detaje të panjohura i quajtur Corona virus Covid-19 nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe e shpallur si pandemi e që tani kjo pandemi i ka "shpallë luftë globale" gjithë njëzimit. Respekt të veçantë për të gjithë ata që janë vijën e parë të frontit në luftë me këtë virus dhe të cilët po e rrezikojnë drejtpërdrejt shëndetin dhe jetën e tyre për të mbrojtur të tjerët dhe duke parandaluar përhapjen e gjerë të këtij virusi.

Sa i përket propozim vendimit për ndarjen e 125,000.00€ ndihmë qytetarëve në nevojë me pako ushqimore dhe higjienike, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së e përkrahim këtë shumë financiare dhe bëjmë thirrje që kjo shumë të rritet edhe më shumë në bazë të mundësive dhe potencialit. mirëpo unë do t'i parashtroj edhe disa pyetje lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, dhe atë, 1- si do të bëhet ndarja e këtyre pakove ushqimor, 2- cilat kategori janë përfitues potencial, 3- a është bërë ndonjë plan se si të menaxhohet me ndonjë përhapje të virusit në një masë më të madhe dhe 4- a kemi ndonjë vend të veçantë për karantinimin e personave të prekur potencial.

Për fund bëjë thirrje që ne si Kuvend i Komunës të jemi të bashkuar për tejkalimin e kësaj situatë të rëndë për vendin duke lënë anash politikat ditore të cilat shpesh herë na ndajnë neve si subjekte politike, por të menaxhojmë këtë gjendje bashkërisht aq sa kemi mundësi ngase qytetarët po presin nga të gjithë ne si përfaqësues të tyre.

z.Benjamin Ejupi, theksoi, Partia e Drejtësisë e ka përcjellë me kujdes gjendjen e krijuar nga Pandemia COVID-19. Siç jemi në dijeni, Komuna jonë është ndër komunat e para të prekura nga ky virus i cili erdhi nga një infektim i një qytetari nga i cili më pastaj u prek familja e tij dhe mandej kemi edhe viktimën e parë nga ajo familje e që shfrytëzoj rastin t'ju shprehë ngushëllime për humbjen e kryefamiljarit të tyre dhe që fatmirësisht i infektuari i par tani më është shëruar.

Kjo gjendje mendojmë se është menaxhuar mirë nga institucionet përgjegjëse, por edhe qytetarët në përgjithësi. Nën kryetari i Komunës z.Nexhmi Rudari ishte në krye të detyrës me të gjithë hapat që ndërmori me Komisionin komunal për veprime dhe masa parandaluese për mbrojtje nga COVID-19 për ngritjen e kapaciteteve në nivel detyre.

Edhe këto mjete të cilat parashihihen të ndahen nga ky Kuvend janë në kuadër të asaj që e potencova më lart, andaj edhe ftoj të gjithë të miratojmë këtë propozim vendim për ndarjen e këtyre mjeteve, për qëllim të ndihmës qytetarëve duke kërkuar po ashtu që këto mjete me të vërtetë të arrijnë në destinacion të duhur, aty ku ka nevoja të mëdha.

Ju lutem edhe një çështje: Meqenëse jam anëtar i Komitetit për Komunitete, dhe ata nuk kanë përfaqësues në Kuvendin Komunal Podujevë, kërkoj që të merren në konsideratë dhe të ndihmohen familjet e ashkalinjëve, romëve dhe të tjerë sepse siç jemi në dijeni gjendja e tyre nuk është e mirë nga ana ekonomike dhe sociale.

z.Pajtim Balaj, theksoi, diskutimi im ka të bëjë me pikën e tretë, propozimin për lirim nga taksa komunale për të gjitha bizneset për vitin 2020. Gjatë fushatës zgjedhore të muajit të fundit, kemi qenë dëshmitar të një vendimi për lirim nga taksa komunale për disa biznese, konkretisht në hapësirën ku po ndërtohet sheshi, vendim i cili na është prezantuar si vendim i Nën kryetarit të komunës dhe kandidatit për kryetar nga radhët e LDK-së. Fakti që në këtë rend të ditës është përfshirë një propozim i tillë, dëshmon që ky ka qenë vendim i gabuar dhe ndoshta edhe i kundërligjshëm, meqë taksat nuk mund të hiqen pa u votuar fillimisht në Kuvend. Futja e kësaj pike në rend dite, për mua do të thotë, që është kuptuar gabimi dhe fatmirësisht po behet përpjekje për korrigjim të tij. Përtej kësaj, konsideroj që kjo taksë nuk ka kuptim edhe përtej situatës pandemike në të cilën ndodhemi, dhe duhet të hiqet.

Ne Ligjin për financat e pushtetit lokal, nocioni taksë shpjegohet kështu, *Taksë - do të thotë një shumë fikse e cila paguhet për pranimin e një privilegji, leje, dokumenti ose shërbimi profesional. Taksat zbatohen për licenca, leje, dokumentet, shërbime të caktuara ose nevoja të tjera për përmbushjen e të cilave nuk ka shumë ndryshim në masën e përpjekjeve, kohën ose materialet e nevojshme.* Nëse bazohemi në këtë definicion, nuk ka asnjë arsye të vazhdohet me këtë taksë ndaj bizneseve. Komuna nuk ka ndonjë shërbim të veçantë për bizneset, si kundërvlerë për kërkimin e një takse të tillë. Dihet mirë që borgjet janë të mëdha dhe që vazhdojnë të rriten, por inkasimi i tyre jo. Krahas kësaj, shumica e komunave të Kosovës i kanë liruar bizneset nga një taksë e tillë.

Kjo vlerësohet si negative edhe në të gjitha indekset e konkurrueshmërisë së bizneseve dhe konsiderohet barrierë në të bërit biznes. Përkundër situatës pandemike, ne vazhdojmë të jemi në proces zgjedhor dhe sjellja e një vendimi të tillë, të kufizuar në kohë, pa e ditur se sa do të zgjatë kjo situatë, besoj që është duke u bërë për shkaqe elektorale, por sido që të jetë, ne si LVV e kemi në programin tonë heqjen e kësaj takse, prandaj sot do të votonim, për, edhe nëse kjo pikë do të futej si pikë e veçantë në rend të ditës.

Për fund kam diçka edhe me këshilltarin z.Avni Islami i cili e tha mos bëni politik, gjë të cilën e kam dëgjuar edhe mbledhjen e kaluar sepse është mbledhja e dytë që unë jam anëtar i Kuvendit, andaj i them atij se Kuvendi është hapësira ku behet politikë dhe një thirrje e tillë për të mos bërë politikë në Kuvend është absurde dhe goxha qesharake.

znj.Lirika Maliqi, theksoi, fillimisht dëshiroj që në këtë kohë pandemie t'ju uroj shëndet dhe siguri të gjithë qytetarëve të Komunës së Podujevës, me shpresën që gjatë këtyre ditëve të kemi mbrojtje dhe kujdes maksimal si në aspektin individual ashtu edhe në aspektin institucional.

Në kuadër të masave mbrojtëse dëshiroj të paraqes para juve disa propozime të cilat me të drejtë besoj se duhet të merren parasysh dhe të zbatohen në mënyrë që të shtohet siguria ende më shumë për qytetarët e Komunës tonë.

Në mungesë të informatës së bashkëngjitur në materialin për këtë mbledhje, zotëri Rudari vetëm i potencoi disa prej tyre siç është dezinfektimi i qytetit në tërësi dhe i ambienteve publike, pastaj dezinfektimi i hyrjeve të blloqeve banesore, dezinfektimi i hapësirave në Lagjen e Dëshmorëve për të cilën mendoj se duhet t'iu ndihmojmë edhe me pako ushqimore, po ashtu propozoi që të bëhet pajisja me dezinfektant në hyrjen e barnatoreve, marketeve dhe furrave të bukës, dezinfektimi i bankomatëve, mirëmbajtja dhe higjiena e parqeve është po ashtu e rëndësishme sepse pavarësisht vendimeve ka një numër të qytetarëve të cilët po e frekuentojnë parkun e qytetit, shtuar kësaj që shpesh herë edhe nuk po respektohet distanca, pastaj prania e organeve të rendit dhe kujdesit që të mos frekuentohen hapësirat publike ose të paktën të ruhet distanca e caktuar e cila është e domosdoshme. Të respektohen vendimet e Qeverisë për shkak se janë derivat i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike gjë kjo e cila nuk do të thotë se nuk duhet të kemi kujdese sepse duhet t'iu përmbahemi vendimeve, mandej të përkujdesemi dhe t'i ndihmojmë nënat vetushqyese me pako ushqimore dhe higjienike.

Për fund, bëj thirrje për të gjithë, që në këto ditë vendimtare t'iu përmbahemi rregullave, të mbahet distancë, higjienë dhe të qëndrojnë në shtëpitë e tyre në mënyrë që të kalohet ky virus sa më shpejt dhe me sa më pak pasoja për qytetarët tanë.

z.Hasan Ajeti, theksoi, sot kemi tri propozim vendime në kuadër të rendit të ditës mbi të cilat jemi këtu në këtë mbledhje, po ashtu ne morëm një informatë në detaje nga Nënkrjetari i Komunës z.Nexhmi Rudari për masat dhe menaxhimin e situatës nga Corona virusi Covid-19, propozime këto të cilat vijnë si rezultat i gjendjes në të cilën është Komuna e Podujevës, dhe mbi këtë bazë unë besoj se duhet të mbështeten nga secili këshilltarë komunal që jemi këtu, duke tejkaluar dhe duke i ikur vijës politike. Gjatë diskutimeve u tha se këto tri propozim vendime kanë element politik, atëherë ju lus që të shikoni vendimet e Kryeministrit të Qeverisë dhe mund të shihni se janë identike, pra nuk ka standarde të dyfishta ngase përderisa Qeveria qendrore paska të drejtë të ndërmarrë masa, atëherë përse nuk ka të drejtë pushteti lokal të ndërmerr masa dhe veprime. Të gjitha ato masa dhe veprime janë në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi.

E mbështes propozimin e z.Avni Islamit dhe njëkohësisht kërkoj nga organet përkatëse që të ndërmarrin masa preventive.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, kjo seancë e thirrur me kërkesën e Ekzekutivit të Komunës drejtuar Kuvendit të Komunës me kërkesën për ndarjen e mjeteve financiare për tejkalimin e situatës emergjente shëndetësore të shkaktuar nga Covid-19, në fillim ishte shumë e mirëpritur nga ne duke dashur që Komuna të jetë sa më afër qytetarëve në këtë kohë, por me të hapë e-mail,in kemi parë një kërkesë të thatë që do të duhej të ishte turp për juve, e dini përse, sepse në këtë kërkesë nuk gjendet kurrfarë plani dhe kurrfarë specifikimi për ndarjen e atyre mjeteve.

Gjendjen e shumë familjeve Llapjane e dimë të gjithë, çfarë ndihme keni bërë gjerë më tani, a keni marrë ndonjë shifër se sa familje kanë nevojë për ndihmë nga kryetarët e fshatrave, absolutisht jo

madje as nuk jeni përkujdesur që numrat e atyre kryetarëve të publikohen në faqe të Komunës me ndonjë sponsorizim e lëre më pa sponsorizim. Jeni duke i detyruar qytetarët që secilin prej nesh të na kontaktojnë për ndonjë ndihmë kurse disa të tjerë as që na njohin por që janë duke u përballur me jetën më të vështirë në këto momente.

Në këtë propozim vendim nuk është specifikuar asnjë kod se ku po merren këto para, vetëm Drejtoritë i keni theksuar, si duket kodeve iu keni rënë paushall. Siç e përmendi edhe shefi i Grupit nga radhët e LVV-së ne propozojmë shumën 150,000.00€ dhe e njëjta të ndahet me këtë plan, si vijon; shuma për pako ushqimore të ndahen për 1000 familje me një vlerë mesatare të pakos 60€, e që në total i bie 60,000.00€ që do të përfshiheshin artikujt esencial ushqimor dhe higjienik, pastaj për dezinfektimin e objekteve publike 10,000.00€, për shëndetësi të ndahen 70,000.00€ kryesisht për furnizim me mjete mbrojtëse për stafin shëndetësorë, zjarrfikësit e të tjerë, madje për aktivitete tjera të paparashikuara ose ad-hoc gjatë pandemisë të ndahen 10,000.00€. Për të gjitha këto sërish duhet të na dërgohet një raport, uroj që këto mjete të shkojnë në destinacionin e duhur.

Për fund uroj dhe shpresoj që kjo pandemi të marrë epilog sa më të shpejt dhe t'i kthehemi normalitetit të jetës.

z.Blerim Maqastena, theksoi, sot si kurrë më parë në këtë kohë krize pandemie na duhet uniteti dhe solidariteti. Vetëm me unitet dhe solidaritet e kalojmë më lehtë pandemin Covid-19 e cila e ka bllokuar vendin dhe botën. Ne si këshilltarë të Kuvendit të Komunës dhe organet komunale në tërësi duhet të jemi sa më afër nevojave të qytetarëve.

Shtabi Emergjent duhet të jetë në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë përfaqësuesit e fshatrave me qëllim të njoftimit të familjeve më në nevojë. Kriza pandemike ka prekur jo vetëm shtresat e varfra por edhe ato të mesme prandaj edhe nevoja për ndihmë është e madhe. Ndihmat duhet t'iu ofrohen familjeve nëpër shtëpitë e tyre e kursesit të bëhet shpërndarja e tyre në masë.

Tani po i paraqesë edhe vërejtjet e mia për pikat e cekura, shuma e propozuar prej 125,000.00€ është e vogël dhe e cila nuk i përmbush nevojat e qytetarëve andaj propozimi im është 200,000.00€ apo varësisht mundësive dyfishi i kësaj shume 250,000.00€, rast konkret kemi Komunën e Drenasit e cila ka ndarë 230,000.00€ apo 5% të buxhetit për investime kapitale, mirëpo pavarësisht propozimit që e bëra unë e përshëndes çdo propozim tuajin si Ekzekutiv i Komunës.

Sa i përket lirit nga pagesa e qirasë për të gjithë shfrytëzuesit e pronave komunale do të ishte dakord nëse falet pagesa për muajt sa zgjatë pandemia, e jo për tërë vitin.

Për fund jam i gatshëm në çdo kohë t'i përgjigjem vullnetarisht çdo organizimi si nga ana e Kuvendit të Komunës ashtu edhe nga Shtabi Emergjent lokal, me qëllim që t'iu dalim në ndihmë qytetarëve.

z.Avni Fetahu, theksoi, dëshiroj të diskutoj lidhur me propozim vendimin për lirimin nga pagesa e qirasë për të gjithë shfrytëzuesit e pronave komunale për vitin 2020. Si zakonisht edhe në këtë propozim vendim mungon informacioni i nevojshëm lidhur me pikat kryesore të cilat do ti potencoj, dhe atë, sa është numri i pronave komunale që do të lirohen e që është jetike për të ditë ne, cila është shuma e planifikuar e cila do të inkasohet, mungesa e atyre mjeteve të parapara për inkasim nga cili fond burimor do të kompensohen për ti realizuar projektet e parapara me ato mjete që do të inkasoheshin, si dhe çështja kryesore dhe thelbësore e kësaj është se krahas vendimit të Qeverisë për subvencionim të qirasë deri në 50% e që vlera totale është 12 milion euro, kjo është një konkurrencë e pabarabartë që zhvillohet mes bizneseve. Nuk qëndron ajo që e tha shefit i Grupit të këshilltarëve të LDK-së se një organ qeveritar ka të drejtë për arsye se vendimi i Qeverisë ka qenë për të gjitha bizneset, nuk ka qenë të ndara siç po ndodh këtu dhe keni parasysh faktin se si do të ndjehen bizneset tjera të cilat nuk e shfrytëzojnë pronën komunale. Pra është një konkurrencë e pabarabartë

dhe jo fer mes tyre, në të njëjtën kohë këtë diskriminim që e keni bërë ndaj bizneseve vetëm lloji i ekspertëve t'juaj mund ta dinë dhe mund ta bënë këtë në krye me Nënkryetarin e Komunës.

Edhe pse forma e propozimit të këtij vendimi nuk është e arsyeshme as në mënyrë profesionale e as përmbajtjesore sepse nuk i përmban pikat të cilat do të duhej të sjelleshin këtu, të paktën nuk pati as argumentim për këtë çështje, për hir të gjendjes dhe bizneseve që e mbajnë shoqërinë tonë ne si Grup i këshilltarëve nga radhët e LVV-së do ta përkrahim këtë propozim vendim.

Për fund, meqë pikat në fjalë u orientuan nëpër forma të ndryshme, se sa është mbajtur hixhiena përmes projektit DDD të cilin ju si Ekzekutiv e dini më së miri qysh i merr tenderët personi në fjalë lidhur me pastrimin e pjesëve të caktuara, shikojeni prej distance vetëm këtë hapësirën këtu se sa është e pastruar dhe ju tregon se sa kanë qenë këta të gatshëm për ta bërë pastrimin nëpër vendet ku kanë qenë të ndjeshme.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sqarim për parafolësin rreth asaj që e ceku se ne në emër të grupit të LVV-së e përkrahim, ishte shefi i Grupit të LVV-së i cili në fillim u prononcua në emër të Grupit, kështu që unë nuk jam në dijeni që ju keni 2 shefa. Unë e dëgjoj një shef të subjektit LVV e jo 2.

z.Bashkim Sylja, theksoi, Grupi i këshilltarëve të PDK-së e përkrah propozim vendimin e Zyrës së Kryetarit të Komunës lidhur me lirimin nga pagesa e qirasë për të gjithë shfrytëzuesit e pronave komunale për vitin 2020. Për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19 shumica e bizneseve të Komunës së Podujevës kanë ndërprerë aktivitetin e tyre, andaj propozimi i cekur është një hap shumë i rëndësishëm për t'ju lehtësuar sa do pak gjendjen në të cilën ndodhen. Bizneset kanë të punësuar punëtorë dhe shuarja e tyre do të paraqiste rrezik që shumë familje të mbesin pa të ardhura. Duke qenë në dijeni se edhe në të kaluarën sektori privat ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në zhvillimin ekonomik të Komunës tonë, në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së propozoj të ndahet një shumë prej 50,000.00€ si ndihmë për bizneset private për pagesën e qirasë.

Në vitet e kaluara buxheti komunal asnjëherë nuk ka arritur të shpenzohet dhe shumë projekte në investime kapitale nuk janë realizuar kështu që një pjesë e buxhetit komunal është kthyer si suficit, andaj kërkojmë të bëhet një fond për t'iu ndihmuar bizneseve. Është shumë e rëndësishme që në këtë kohë pandemie ky Kuvendi të merr vendime në të mirë të qytetarëve dhe bizneseve në mënyrë që ta tejkalojmë këtë situatë në të cilën ndodhemi aktualisht.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, fillimisht shpreh ngushëllime familjes Haliti nga fshati Dumnice për vdekjen e familjarit të tyre, dhe dashtë Zoti të mos ketë më viktimë nga kjo sëmundje.

Sot në këtë gjendje krize globale nga pandemia Covid-19 që gjendet bota, Kosova dhe Komuna jonë, duhet unitet i plotë për ndihmë popullit dhe qytetarëve tanë. Vet thirrja e kësaj seance të jashtëzakonshme me të vetmen pikë të rendit të ditës se si do të përballemi me këtë situatë dhe cili do të jetë kontributi i të gjithë neve pa dallime politike në kriza të përgjithshme qytetare tregon karakterin e secilit prej neve këtu që jemi të zgjedhur të popullit, se sa mund të japim nga vetja jonë personale por edhe nga subjektet tona politike që përfaqësojmë si dhe a barikadohemi në konserva politike të ngushta dhe qëllime të ndryshme të cilat në situata të jashtëzakonshme veç sa e zbehin aktivitetin e secilit subjekt politik. Deklarimet politike sot këtu në këtë situatë nuk kanë vlerë të madhe, por kanë vlerë idetë se çfarë mund të ndihmojmë ne si institucion qytetarëve të cilët kanë nevojë dhe presin ndonjë gjë prej vendimeve tona.

Sa i përket kësaj seance, të gjithë jemi në dijeni se kjo është e jashtëzakonshme dhe nuk mund të plotësohet apo ndryshohet rendi i ditës, andaj si rrjedhojë kemi këtë rend dite me 3 nënpika tjera për diskutim lidhur me ndihmën që mund t'ju bëjmë qytetarëve. Nuk diskutohet votimi i shumës së paraparë për shërbim ndaj njerëzve të cilët kanë nevojë, por lus edhe Komunën e Podujevës por edhe gjithë të tjerët që në qoftë se ka ndonjë qasje në ndonjë donatorë eventuale i cili shpreh gatishmëri t'ju

ndihmoj qytetarëve të Komunës së Podujevës që në mënyrë të organizuar t'i drejtojmë ndihmat dhe këshillimet tona në secilën familje që ka nevojë qoftë në skemat sociale apo të dyshimeve për Covid-19. Dëgjova me vëmendje diskutimin e këshilltarit z. Avni Islami rreth tri fshatrave që janë futur në karantinë dhe nevojës së tyre për ndihmë, Nënkryetari i Komunës në fjalimin e tij deklaroi se është formuar Shtabi Emergjent në nivel komunal, mirëpo i nderuari Nënkryetar nëse karantinimi vazhdon në ato tri fshatra, për t'ju lehtësuar punën juve dhe banorëve të atyre fshatrave është mirë të formohen nën-shtabet lokale apo një nën-shtab operativ për teren në mënyrë që të skanohet gjendja se kush duhet të ndihmohet së pari në vendet që janë në karantinë dhe që janë të prekura direkt me Covid-19 e deri më tani jemi në dijeni se vetëm në fshatrat Dumnice e Epërme dhe Bradash kemi të infektuar, andaj fillimisht aty duhet të merren masa për arsye se banorët e atyre fshatrave nuk mund të lëvizin të lirë ashtu siç mundën qytetarët tjerë jashtë orës policore.

Sa i përket propozimit për lirim nga taksat komunale mendoj se të gjitha bizneset që janë të mbyllura qoftë ato të cilat shfrytëzojnë pronën publike apo atë private, është mirë i nderuari Nënkryetar që të shikohet buxheti për arsye se keni qasje direkte në buxhetin komunal dhe në të hyrat vetanake, mandej jeni në dijeni edhe për shumën buxhetore e cila ka mbetur dhe që është në dispozicion, normal në kuadër të lejimeve ligjore, të subvencionohen edhe bizneset private të cilat kanë qira dhe janë të mbyllura. Jemi në dijeni për vendimet e nivelit qendror dhe ndarja e buxhetit për paga prej 170€ për punëtorët e sektorit privat të cilët janë të lajmëruar, por ka informata se ka edhe biznese të cilat mbajnë punëtorë të pa lajmëruar e të cilët në këtë kohë vërtetë janë në gjendje të keqe së bashku me familjet tyre, lus të gjithë pa përjashtim, që me këtë shumë të paraparë sipas propozim vendimit përkatës, duke mos qenë në dijeni rreth mundësisë së ndarjes së një shume më të madhe për ndihmë qytetarëve dhe bizneseve, pastaj jeni në dijeni se unë kam qenë kritik i madh i shfrytëzimit të pronës publike rreth asaj se kush dhe si e shfrytëzon, mirëpo në situata të jashtëzakonshme duhet të kemi unitet të plotë sikurse që është përkrahja për këtë shumë fillestare të mjeteve financiare ngase nuk e dim se kur do të përfundoj ky virus por duke shpresuar në një kohë të shkurtër që të përfundoj, por që këtë shumë duhet ta votojmë, mirëpo ndoshta do të ishte më profesionale nga ana e Nënkryetarit të Komunës apo ndonjërit nga Ekzekutivi i Komunës që të jep propozimin final ngase pati propozime të ndryshme gjatë diskutimeve, pra të dihet mënyra e shpërndarjes së ndihmave dhe kush do ta merr përsipër këtë proces. Mandej do të ishte mirë të sillej edhe lista e familjeve të para të intervenimit e që ndoshta Drejtoritë përkatëse mund ta kenë gjendjen e secilës familje dhe e din se ku duhet të intervenohet në start, mirëpo do të ishte mirë që para votimit të sqarohet kjo çështje se a do të merren parasysh propozimet e këshilltarëve apo do të jepet propozimi adekuat nga ana e Ekzekutivit në mënyrë që në fund kur ta kalojmë këtë situatë pandemie ta kemi edhe një raport rreth kësaj çështjeje. Kjo për arsye se shumë familje janë lajmëruar edhe në mënyra individuale, madje ndoshta edhe tek Nënkryetari i Komunës kanë mbërritur telefonata private për ndihmë, pastaj kemi pas deklarime mediale se në fshatin Dumnice ka pas keqpërdorime politike rreth shpërndarjes së ndihmave madje edhe duke u përmendur edhe me emrat e familjeve të cilat kanë pas nevojë në ato fshatra të cilat kanë qenë në karantinë e që mendoj se intervenimi i parë duhet të bëhet mu në ato fshatra që janë në karantinë. Jemi në një gjendje më shumë se lufte për arsye se qytetarët janë të hezitur të komunikojnë dhe nuk jemi në gjendje ta dimë se ku gjendet armiku/bakteri, kush me kënd ka komunikuar etj, kështu që PDK e voton në tërësi këtë pako fillestare të ndihmës për qytetarët përkatësisht këtë shumë të mjeteve buxhetore të paraparë nga Komuna e Podujevës, njëkohësisht kërkojmë që nëse kjo situatë zgjatë, kjo pako të rritet por edhe në këtë periudhë Ekzekutivi i Komunës të mos hezitoj që të gjithë neve të na kontaktoj nëse veç e vlerëson se i duhemi për ndonjë ndihmë fizike apo ndihmë tjetër për qytetarë e që besoj se të gjithë jemi në gjendje gatishmërie sepse për atë arsye jemi edhe këtu.

z.Bunjamin Hoti, theksoi, gjendja e krijuar nga pandemia me Corona virus na ka vendos edhe neve në një situatë emergjente shëndetësore ashtu sikurse gjithë botën. Në vazhden e përpjekjeve të të gjitha institucioneve të Kosovës edhe Komuna e Podujevës përbën aktivitetet e saja në mënyrë që të jetë sa më afër nevojave të qytetarëve si dhe me aktivitetet dhe format e saja që ka në dispozicion të lehtësoj sa do pak punën dhe jetën qytetarëve në këto momente pandemike.

E mbështes dhe e përkrahi dhe po ashtu është për tu falënderuar punën e madhe që ka bërë në këtë periudhë Komuna e Podujevës me aq sa ka pasur mundësi Nënkrjetari i Komunës z.Nexhmi Rudari me punën në terren, me aktivitete në bashkëpunim me Shoqatat humanitare, me njerëz të vullnetit të mirë si dhe me të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës, natyrisht duke qenë në dijeni se ka nevojë dhe hapësirë ende më shumë.

Po ashtu rastet e fshatrave Dumnice e Epërme dhe ajo e Poshtme, fshati Llaushë, edhe Nënkrjetari i komunës në disa raste ka kërkuar disa herë por të njëjtën gjë po e bëjë edhe unë si këshilltarë i Kuvendit të Komunës që edhe njëherë Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik ta shqyrtoj vendimin përkatës dhe të vije me një rekomandim ndryshe për shkak se falë Zotit nuk po ka shtim të rasteve në at zonë dhe po duket se gjendja është më mirë. Jeta e tyre nuk është e lehtë dhe këtë e them edhe në bazë të kontakteve të përditshme që kemi por që nuk është duke ndodhur vetëm në Podujevë por është gjendje e cila është duke ndodhur në gjithë Kosovën po thuajse dhe jashtë saj.

Ndarja e këtyre mjeteve nuk ka dyshim se do të shkoj në vendin e duhur dhe do t'ju lehtësohet jeta e familjeve që kanë më së shumti nevojë për ndihmën tonë. Nëse e shohin në aspektin moral dhe në aspektin fetar e kemi për obligim që sot të tregohemi të gjithë së bashku, të jemi pran njëri tjetrit në mënyrë që me këtë vendim t'ju lehtësojmë jetën atyre që janë duke respektuar vendimet e institucioneve duke qëndruar të izoluar dhe të ndarë nga rrethi i tyre social në mënyrë që në këtë formë të bëhet parandalimi dhe të evitohet sa më shumë përhapja e këtij virusi vdekjeprurës e që falë Zotit ne kemi vetëm 1 rast e për të cilin shpreh ngushëllime familjes dhe rrethit dhe urojmë që ky rast të jetë i fundit dhe të mos përsëritet më as në Komunën e Podujevës por as përtej saj.

Institucionet të cilat kanë punuar gjatë kësaj kohe në mënyrë më të mirë të mundshme, duke filluar prej Kryqit të Kuq e deri tek Komuna e Podujevës i përgëzoj dhe iu kërkoj që të vazhdojnë punën e tyre edhe më tutje. Po ashtu edhe unë i bashkëngjitëm thirrjes apo vullnetit të mirë të këshilltarit të Kuvendit nga PSD i cili e tha se jam në dispozicion në institucioneve komunale por edhe atyre jo qeveritare që t'iu ndihmojmë në tejkalimin e kësaj situatë.

Sa i përket çështjes së të bërit politikë është e vërtetë se Kuvendi i Komunës është vend ky zhvillohen politikat, edhe unë por edhe Grupi i këshilltarëve të LDK-së jemi të gatshëm të bëjmë politikë, por vendi dhe koha nuk është për një gjë të tillë, është koha që të marrim veprime të shpejta, ti përkrahim këto propozime dhe të marrim vendim në mënyrë që qytetarët ta shohin dorën tonë si këshilltarë të Kuvendit që po iu ndihmojmë, po jemi pran tyre dhe që me këto vendime sa do pak t'jua lehtësojmë jetën qytetarëve të cilët janë nëpër shtëpitë e tyre.

Për fund unë po vërej se është një vullnet i mirë i përbashkët i shumicës së këshilltarëve të Kuvendit në mënyrë që t'i kalojmë këto propozime dhe të marrim masa në atë që kemi në dorën tonë duke shpresuar që këto të jenë masat e fundit lidhur me situatën e krijuar nga pandeminë dhe të mos ketë më nevojë për masa shtesë lidhur me këtë çështje, mirëpo kërkoj nga institucionet komunale, përkatësisht nga Ekzekutivi i Komunës që të jemi në gatishmëri edhe për situata tjera që mund të na paraqiten. Po ashtu sa i përket kësaj pjesës së kësaj salle të Teatrit, konkretisht dërrasave këtu që u cekën, i nderuar ish shef i Grupit ju rikujtoj se DDD nuk është kompani e pastrimit por është për Dezinsektim Derratzim dhe Dezinsektim.

z.Avni Islami, theksoi, deri më tani të gjithë diskutuesit po thuajse japëm kontributin tonë por më shtyu të marr fjalën diskutimi i këshilltarit paraprak **z.Rafet Llapashtica** i cili ishte shumë përmbajtësor me propozime, vërejtje dhe ide si dhe çka është më e rëndësishmja fokusimi për pjesën/zonën prej nga unë vij e që siç e potencova edhe më parë që 18 ditë është e izoluar në karantinë e që mendoj se në ato fshatra unë mendoj se është përdorur standard i dyfishtë, dhe këtë e arsyetoj se në fshatin Bradash është lajmëruar një rast i infektuar me Covid-19, e njëjta situatë është edhe në fshatin Dumnicë e Epërme, kurse në këtë zonë 4 fshatra hyjnë në karantinë që 18 ditë, ndërsa në fshatin Bradash, e që mendoj se është e drejtë ajo që është vetë izoluar familja, dhe nuk ka pasur raste të tjera, pra nuk është e drejtë që të përdoren standarde të dyfishta nga kush do qoftë.

Ju siguroj se për çdo ditë kam gravituar në 4 fshatrat dhe pothuajse 90% të familjeve i kam vizituar, të gjitha rekomandimet e mia i kam përcjellë tek Nënkrjetari i Komunës **z.Nexhmi Rudari**.

Për fund, propozoi që kjo shumë buxhetore e caktuar, e cila mendoj se nuk i plotëson nevojat por vetëm për një kohë të caktuar, mirëpo ne si Kuvend i Komunës secili prej nesh besoj se jemi të gatshëm në çdo moment të thirren mbledhje të Kuvendit në mënyrë që të ndahet edhe ndonjë shumë tjetër financiare. Pra për fillim ftoj ta votojmë këtë shumë prej 125,000.00€ e pastaj të shohim si po rrjedhin gjërat dhe mund të ulemi sërish të diskutojmë.

z.Mirsad Kamerolli, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik – DPZHE, theksoi, fillimisht shpreh ngushëllime familjes Haliti për humbjen e familjarit të tyre dhe shërim të shpejt gjithë atyre që janë të prekur nga Covid-19.

Masa për lirimin nga tarifa komunale për bizneset në Komunën e Podujevës në këtë periudhë besoj se është më se e nevojshme. Besojmë dhe shpresojmë që edhe masat e ndërmarra edhe nga ana e Qeverisë së Kosovës për përkrahje të sektorit privat duke përfshirë edhe mbështetjen e pagave për të punësuarit si dhe qiratë do të japin efekt pozitiv dhe të mos ketë nevojë që Komuna të bëjë ndarje shtesë të mjeteve financiare për mbështetjen e këtij sektori i cili faktikisht është duke u përballuar dhe do të përballlet me vështirësi në gjithë Kosovën e në veçanti në Komunën e Podujevës.

Sa i përket tarifës, ne do të shikojmë mundësitë që nga viti i ardhshëm të heqim këtë tarifë por lidhur me atë që u tha se vetëm ne e kemi këtë tarifë nuk qëndron ajo sepse ka shumë Komuna të cilat e kanë në fuqi këtë tarifë kështu që ky propozim vendim nuk është politik por është vendim i cili i takon këtij Kuvendi dhe këtij Ekzekutivi ta miratoj.

z.Nexhmi Rudari, Nënkrjetar i Komunës, theksoi, dëshiroj t'ju falënderoj të gjithëve që morët fjalën dhe kontribuat në mbarëvajtjen e kësaj seance të jashtëzakonshme.

Sa i përket shumës financiare të propozuar prej 125,000.00€ sipas propozim vendimit në fjalë, dëshiroj t'ju njoftoj se kjo shumë i bashkëngjitet shumës prej 237,000.00€ që deri më tani Komuna ka ndarë nga kode të caktuara buxhetore por që nuk kemi pas nevojë të mbahen seanca të Kuvendit për t'i alokuar ato mjete sepse kemi pas dhe kemi mundësi që me kontrata të rregullta të kryhen aktivitete përkatëse. Do të thotë se shuma totale e Komunës së Podujevës e ndarë deri më tani arrin 362,000.00€ përfshirë edhe këtë të propozuar për këtë seancë.

Nëse një situatë e tillë vazhdon ne sërish do të ulemi dhe bashkërisht me Ju do të ndajmë edhe ndonjë shumë tjetër edhe prej kategorisë për investime kapitale sepse ashtu edhe siç u cek tani edhe na mundësohet një gjë e tillë me Ligj që 5% prej kësaj kategorie t'i ndajmë për përballje me këtë fatkeqësi. Po ashtu dëshiroj të ndaj me ju një lajmë të mirë ku ne si Komunë kemi bërë një kërkesë në Asociacionin e Komunave të Kosovës - AKK me të cilën kemi kërkuar që për këtë vit të hiqen ndëshkimet dhe kamatat në tatimin në pronë, e që pastaj AKK këtë kërkesë e ka paraqitur si kërkesë të Komunave të Kosovës, të njëjtën e ka prezantuar në Ministrinë e Financave dhe Transfereve e që pastaj Ministri ka dhënë sinjale shumë pozitive që do të merr vendim që kamatat dhe ndëshkimet për tatim në pronë për vitin 2020 do të hiqen e që do të ishte lajmë shumë i mirë.

Sa i përket asaj që u kërkuar të ngritet një komision për ndarjen e ndihmave, ne kemi një komision të tillë në nivel të Komunës i cili përbëhet nga 3 zyrtar komunal (2 prej tyre nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, dhe 1 përfaqësues i Qendrës për Punës Sociale – QPS) dhe listat kryesisht vijnë nga QPS, Kryqi i Kuq, nga DSHMS dhe të tjerë.

Sa i përket çështjes së karantinës, këshilltari z.Avni Islami është në dijeni shumë mirë që ne në vazhdimësi si Komunë dhe si Ekzekutiv kemi bërë kërkesë që karantina të hiqet dhe të zëvendësohet me një masë më të butë siç është izolimi, mirëpo IKSHP ka konsideruar fshatin Dumnicë e Epërme si vatër burimore e virusit, andaj edhe deri më tani nuk e ka heqë. Dje kemi marrë informatën e fundit që posa do të dalin analizat e fundit të pacientes e cila është nga fshati Bradash por që për momentin jeton në fshatin Dumnicë tek familja e saj, atëherë do të shqyrtohet dhe presim që brenda kësaj jave ajo zonë ku përfshihen 4 fshatra do të hiqen nga karantina dhe do të vlej masa e izolimit të familjeve e që do të ishte një lehtësim i madh edhe për ne si Komunë por edhe për Policinë sepse janë 4 ekupe policore të cilat alokohen në pjesë të ndryshme të asaj zone edhe përkundër mungesës së stafit të tyre që kanë për mbikëqyrjen e zonës që është në karantinë.

Edhe njëherë ju falënderoj dhe dhashtë Zoti që seancën e ardhshme mos ta kemi të jashtëzakonshme por seancë të rregullt e që nënkupton edhe tejkalimin e kësaj situate emergjente shëndetësore.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, falënderoj të gjithë për kontributin e dhënë.

Meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, unë vë në votim propozim vendimet, në pako, sipas thirrjes dhe materialit përkatës përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri u miratuan, në pako, propozim vendimet sipas propozim vendimeve përkatëse dhe konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

***Kryesuesi i Kuvendit**, duke i'u shpreh ngushëllime familjeve për humbjen e familjarëve të tyre dhe duke i'u dëshiruar shërim sa më të shpejt të gjithë të infektuarve me Covid-19 dhe numër sa më të vogël të të prekurve, e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.*

Mbledhja përfundoi në ora 11:35

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-016/01-0020193/20

Podujevë,

02 prill 2020

Kryesuesi i Kuvendit

Fatmir Gashi